

Informatat mbi projektin

Emri i projektit:	Platformë online për personat me aftësi të kufizuar
Organizata Implementuese:	Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar - FKAK
Kontaktet e organizatës: Adresa, email, telefonat, web faqja	Rr. Tring Smajli, Nr.47, 10000, Prishtine, Kosovë info@kdf-ks.org www.kdf-ks.org https://www.facebook.com/Kosova-Disability-Forum-1023476471130453 +381 38 400 055
Kohëzgjatja:	Data e fillimit: 01/09/2020 Data e përfundimit: 31/12/2020
Buxheti:	4,900.00 EUR
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Përmbledhje e intervenimit:	Duke qenë se personat me aftësi të kufizuara janë një kategori e personave më të rrezikuar ndaj cdo lloj situatë të jashtëzakonshme, qoftë ajo natyrore apo civile, qëllimi i këtij projekti është të themelohet një platformë që do të ketë shtrirje në tërë territorin e Kosovës, përmes së cilës personat me aftësi të kufizuara mund të marrin të gjitha informacionet e duhura në një gjuhë të thjeshtë dhe qasje të disponueshme, lidhur me efektin e drejtpërdrejtë që mund të ketë situata e jashtëzakonshme tek kjo kategori e personave. Meqenëse pandemia COVID-19 përbën një situatë të jashtëzakonshme aktualisht, platforma do të shërbejë për të ofruar informacione mbi COVID, regjistrimi mbi shërbimet që mund të marrin fëmijët me aftësi të kufizuara në rastin e izolimit (shërbime psikologjike, rehabilituese, sociale), si të mbrohen nga pandemia dhe lista e ekspertëve që do të ofrojnë shërbime me të dhënat kryesore mbi ta. Platforma poashtu do të përmbajë informacione mbi situatat e tjera të jashtëzakonshme, regjistrimi si donatorë (mjete financiare apo lloj tjetër ndihme nga individët), paraqitja e ankesave për institucione apo shërbime për personat me aftësi të kufizuara, numrat e kontakteve ku mund të drejtohen për informata etj.

Bashkëfinancuar nga: